



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:097294

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05948862

Ac.nr.2000/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtaret Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, H.S nga Gjilani, rr. "...", të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.H, avokat në Gjilan, kundër të paditurve I.S nga Gjilani, rr. "...", të cilin e përfaqëson J.I, avokat nga Gjilani dhe R.G nga Gjilani, rr. "...", me objekt kontesti, anulim i kontratës dhe vërtetim i të drejtës së pronësisë, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.676/2020, i datës 06.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit I.S nga Gjilani, rr. "...", ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.676/2020, i datës 06.01.2020 PRISHET dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.676/2020, i datës 06.01.2020 ka vendosur si në vijim:

"I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses H.S nga Gjilani rr."..." dhe VËRTETOHET se paditësja në bazë të parashkrimit fitues –mbajtjes është pronare e pronësisë në pjesën prej ½ e njësisë kadastrale P-..., në vendin e quajtur "...", në sipërfaqe prej 308 m2, e cila në DGJKP sipas certifikatës me numër të lëndës ..., të datës 22.08.2017 evidentohet në emër të I.S nga Gjilani si dhe të obligohet i padituri që këtë të drejtë t'ia pranoj paditëses dhe të lejoj të njëjtën që në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi ta regjistroj në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në emër të saj.

IIREFIZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë për ndarje fizike, për paluajtshmërinë e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

III.REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë me të cilën paditësja ka kërkuar që të anulohet kontrata e dhuratës LRP 1484/2017 Ref.280/2017, e datës 22.02.2017 e lidhur ndërmjet R.G si dhuratëdhënës dhe I.S si dhuratëmarrës për paluajtshmërinë me numër P-..., në vendin e quajtur “...” në sipërfaqe prej 308 m², ZK Gjilan.

IV.Secila palë i bartë vetë shpenzimet e procedurës kontestimore”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka parashtruar i padituri I.S, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykim i atakuar të prishet dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në të njëjtën gjykatë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësja me propozim që ankesa e të paditurit të refuzohet e pa bazuar ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësja ka parashtruar padi me datë 14.09.2017, pranë Gjykatës së shkallës së parë për anulimin e kontratës së dhuratës dhe vërtetim të pronësisë, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe pas vlerësimit dhe administrimit të provave në shkresat e lëndës ka marrë aktgjykimin, C.nr.676/2020, i datës 06.01.2020, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, dhe duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se nga vërtetimi i gjendjes faktike ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditëses ka bazë ligjore sa i përket vërtetimit të pronësisë dhe të njëjtën e ka aprovuar pjesërisht ashtu që ka vërtetuar se paditësja është pronare e ½ të pjesës së ngastrës kadastrale kontestuese me që është vërtetuar themelësia e saj ashtu që paditësja në bazë të nenit 28 të LTHMPJ-së, e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, e në rastin konkret nga provat e administruara është vërtetuar se paditësja ngastrën kontestuese e ka shfrytëzuar me mirëbesim afër 30 vite, në këtë rast pushtetin faktik, paditësja e ka ushtruar në pronën kontestuese, përkatësisht e ka poseduar dhe shfrytëzuar e pa penguar nga askush që nga viti 1990 e tutje, është shndërruar në pushtet juridik dhe për këto arsye, ka theksuar se ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e fakt ky i cili

është vërtetuar edhe me deklarinimin e palës së paditur e cila nuk ia ka mohuar të drejtën e pronësisë dhe ka pranuar që e njëjta është pronare e ½ të pjesës ideale të pronës kontestuese.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ajo çka ka qenë kontestuese në mes të palëve është pjesa sa i përket rrugës e cila shtrihet përgjatë dy bashkëpronarëve faktik të njësisë kadastrale 461-10, mirëpo Gjykata ka shtuar se sa i përket kërkesë së palëve lidhur me këtë pjesë nuk është lëshuar në vendosje, për arsye të mos tejkalimit të kërkesëpadisë pasi që pala paditëse me kërkesëpadi ka kërkuar vetëm vërtetimin e pronësisë në pjesën prej ½ të njësisë kontestuese si dhe anulimin e kontratës mbi dhuratën andaj Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vendosur bazuar në dispozitën e nenit 2.1 të LPK-së. Po ashtu ka shtuar se e ka refuzuar edhe pjesën tjetër për zgjerim të kërkesëpadisë me të cilën paditësja ka kërkuar që të bëhet ndarja fizike si e pa bazuar pasi që e njëjta nuk e ka precizuar në padie dhe zgjerim të padisë në mënyrë të saktë kërkesën e saj dhe për të njëjtën nuk është bërë ekspertizë nga ana e ekspertit gjeodet, sa i përket kësaj kërkesë e po ashtu gjykata e ka vlerësuar ekspertizën e ekspertit të komunikacionit por e njëjta nuk ishte relevante për kërkesat të cilat gjykata ka vendosur në bazë të kërkesëpadisë si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket mënyrës së vendosjes sikurse në pikën III të dispozitivit, Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se e refuzoj kërkesëpadinë e paditëses sa i përket anulimit të kontratës mbi dhuratën ngase nuk ka asnjë bazë ligjore edhe pse paluajtshmëria kontestuese e cila ishte në emër të paditurit të dytë R.G nga Gjilani, në tërësi ishte bartur në emër të paditurit I, e gjykata ka theksuar se e ka vërtetuar se e njëjtat ishte bartur vetëm përkohësisht në mënyrë që më pas pjesa tjetër prej ½ të bartet në emër të paditëses si posedueses faktike, e këtë fakt nuk e kishin kontestuar as të paditurit, andaj Gjykata ka theksuar se lidhur me këtë ka vendosur bazuar në nenin 319.1 dhe 322 pika 1 dhe 2 të LPK-së, e në rastin konkret sa i përket anulimit të kontratës mbi dhuratën nuk ka pasur bazë ligjore.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n), e LPK-së, po ashtu kemi vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e më pas edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, e të cilat e bëjnë aktgjykimin e atakuar të pa qëndrueshëm dhe si i tillë detyrimisht është dashur që të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim për arsyet e dhëna si më poshtë.

Gjykata e Apelit e Kosovës nuk e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ku si rezultat i vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Qëndron pretendimi ankimor i të paditurit se, aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, ngase sipas të paditurit dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i themeltë.

Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar si i tillë është i pa qartë, në kundërshtim me vetveten, pastaj i pa përshtatshëm për përmbarrim, por në kundërshtim edhe me arsyet e dhëna në pjesën arsyetuese, për më tepër është e pa qartë se si Gjykata në një pikë të dispozitivit e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses duke vërtetuar se paditësja është pronare në ½ në bazë të parashkrimit fitues, ndërsa në pikën tjetër të dispozitivit të aktgjykimit e refuzon kërkesëpadinë sa i përket anulimit të kontratës për dhuratën, kur kjo paluajtshmëri ka qenë pikërisht edhe objekt i kontratës për dhuratën. Gjykata e Apelit e ka të pa qartë se si do të mund të bëhet regjistrimi i kësaj paluajtshmërie në emër të paditëses si bashkëpronare me ½ në paluajtshmërinë kontestuese kur Kontrata për Dhuratën ka mbetur në fuqi, ndërsa arsyetimi i Gjykatës së shkallës së parë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë për anulimin e kontratës për dhuratën është e pakuptueshme, pasi që është e pa qartë se si e ka vërtetuar Gjykata faktin se paluajtshmëria kontestuese ishte bartur në emër të të paditurit I. vetëm përkohësisht, e nëse do të qëndronte ky fakt atëherë përse i padituri vullnetarisht nuk ia ka bartur pronësinë paditëses në pjesën tjetër prej ½ të paluajtshmërisë kontestuese.

Tutje Gjykata e Apelit gjen se as gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pasi që Gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të japë arsye lidhur me faktet vendimtare që kanë qar deri në aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses, dhe atë për faktin se në rastin konkret kërkesa e paditëses ka pasur të bëjë me vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe e njëjta vazhdimisht e ka potencuar se paluajtshmëria, pra një pjesë e saj bashkëshorti i saj e ka ndërtuar një shtëpi diku në vitin 2006, në të cilën shtëpi jeton paditësja së bashku me fëmijët e saj, ndërsa Gjykata e shkallës së parë ia njuh të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues duke konstatuar se e ka pasur në posedim dhe shfrytëzim paluajtshmërinë kontestuese që nga viti 1990 e tutje.

Si rezultat i shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka rezultuar edhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Në ri procedure gjykata duhet të eliminojë të metat që e kanë shoqëruar aktgjykimin e atakuar ashtu që fillimisht të zbatoj drejtë dispozitat procedurale, të vlerësojë padinë në kuptim të dispozitave nga neni 99 se a është e qartë dhe e plotë, të vlerësoj parashtrësën për precizim të kërkesëpadisë së paditësit të datës 31.05.2018 dhe nëse njëra ndër kërkesat e palës paditëse ka qenë për ndarje fizike, për paluajtshmërinë që është objekt kontesti, të vlerësoj se a duhet kjo kërkesë (sa i përket ndarjes fizike) të trajtohet në procedurë kontestimore apo në ndonjë procedurë tjetër konform dispozitave të aplikueshme në vendin tonë, pastaj të sqaroj faktin se në çfarë baze paditësja kërkon vërtetimin e pronësisë, në bazë të trashëgimisë, apo parashkrimit

fitues ashtu siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë, të sqaroj çështjen e anulimit të kontratës për dhuratën, pastaj të vërtetojë saktë dhe drejtë gjendjen faktike, kush e ka në posedim pasurinë që është objekt kontesti dhe nga cila kohë, pastaj të vlerësojë tërë procedurën trashëgimore, më pastaj pas sqarimit të të gjitha rrethanave dhe vlerësimit të të gjitha provave, duke marrë për bazë dhe vlerësuar edhe të gjitha pretendimet e palës së paditur, të bie vendim të drejtë dhe duke iu përmbajtur elementeve të përcaktuara në nenin 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2000/2020, me datë 04.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.